



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

VENDIM
Nr. 1, Datë 19.10.2020

**PËR EMËRIMIN E AUDITIT TEKNICIENË PËR MBIKËQYRJEN E PROCESIT TË
HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË
DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 19 pika 1 germa “n” dhe pika 2, neni 61 pika 2 dhe pika 3 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 2, datë 28.12.2012 “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGjC, pasi shqyrtoi propozimet për auditët teknikienë dhe dokumentacionin e paraqitur;

V Ë R E N

Referuar nenit 61, pika 2 dhe pika 3 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbikëqyr procesin e hartimit të listave duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Jo më vonë se 30 ditë nga data e dekretimit të zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëron me vendim dy auditë teknikienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Të drejtën e propozimit për auditët teknikienë e kanë respektivisht Komisioneri dhe Nënkomisioneri. Auditët teknikienë ndihmohen nga jo më shumë se 2 ndihmësa, të cilët caktohen nga KQZ-ja me propozimin e auditit.

Auditët teknikienë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Të kenë arsim universitar dhe eksperiencë në fushën e zgjedhjeve;
- b) Të ketë njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit apo statistikës, si dhe në procesin e hartimit të listave të zgjedhësve dhe/ose gjendjes civile;
- c) Të jenë të padënuar penalisht, së bashku me jetëshkrimet e tyre.

Të drejtat, detyrat dhe kushtet e kontratës së lidhur ndërmjet KQZ-së dhe auditeve teknikienë përcaktohen në udhëzimin e KQZ-së nr.2, datë 28.12.2012 të KQZ.



Pas konsultimeve të bëra referuar nenit 61 pika 2 dhe pika 3 të Kodit Zgjedhor, Nënkomisioneri me shkresën nr.1640 prot., datë 14.10.2020, ka caktuar si audit teknikienë z. Roland Kërçuku.

Kohëzgjatja e kontratës së z. Roland Kërçuku KQZ-në, do të jetë nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar, 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Duke pasur parasysh ngarkesën e punës dhe kohëzgjatjen e kontratës duhet të shpërblehet me 120 mijë lekë për të gjithë kohën e angazhimit të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1 germa “n” dhe pika 2, dhe nenit 61 pika 2 dhe pika 3 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

V E N D O S A:

- 1- Të emëroj audit teknikienë për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, z. Roland Kërçuku, caktuar nga Nënkomisioneri i KQZ-së.
- 2- Të caktojë masën e shpërblimit në vlerën 120 mijë lekë për auditin teknikienë për gjithë periudhën, nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar.
- 3- Ngarkohet auditi teknikienë të propozojë ndihmësin brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 5- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

KOMISIONER

Hirjan CELIBASHI

